



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës/Ministarstvo Obrazovanja i Nauke
Ministry of Education and Science*

**MINISTRIA E ARSIMIT E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Thirrje për pjesëmarrje në Seminarin XIX me mësuesit e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë

Tema:

Motivimi i nxënësve në diasporë për mësimin e gjuhës shqipe dhe ruajtjen e identitetit kombëtar

Ministria e Arsimit e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Kosovës organizojnë Seminarin XIX, me mësuesit e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë, **në datat 28–31 korrik 2026, në Kosovë.**

Ftohen mësuese/mësues të gjuhës shqipe në diasporë të kontribuojnë me punimet e tyre sipas tematikave të mëposhtme:

1. Metodatat bashkëkohore në mësimdhënie dhe roli i tyre në motivimin e nxënësve.
2. Identiteti kombëtar si motivim për ruajtjen dhe mësimin e gjuhës shqipe.
3. Motivimi i nxënësve përmes përdorimit të materialeve dhe aktiviteteve tërheqëse.
4. Dygjuhësia, praktikë motivuese për mësimin e gjuhës shqipe.
5. Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin për motivimin e nxënësve.

- Mësueset/mësuesit e mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë, të interesuar për **prezantime në punëtori**, në përputhje me tematikat e mësipërme, të aplikojnë me abstrakte në linkun:

<https://forms.gle/u3CSQVoSfBvKtmJ16>



Aplikimi: 25 maj – 9 qershor 2026

Njoftimi për pranimin e abstrakteve: **12-15 qershor 2026**

Dorëzimi paraprak i prezantimit të plotë (në word, powerpoint etj.): deri më **15 korrik 2026**

Shënim: Përparësi do të kenë mësueset/mësuesit që prezantojnë për herë të parë.

- Mësueset/mësuesit e mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë, të interesuar për **pjesëmarrje në seminar**, të aplikojnë në linkun:

<https://forms.gle/nDoAvbDJMYfZWrvs7>



Aplikimi: 25 maj – 9 qershor 2026

Njoftimi për pranimin e pjesëmarrësve në seminar: **12-15 qershor 2026**